



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:207383

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05587489

Ac.nr.7334/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Halide Reka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Fatmire Zeneli nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B..... A..... avokat nga Prishtina, Rr.”Agim Ramadani” A3 nr.45, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga M..... D....., me objekt të kontestit kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2092/15, të datës 21.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2092/15, të datës 21.09.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2092/15 të datës 21.09.2022, në pikën e I-rë të dispozitivit e ka aprovuar **pjesërisht** të bazuar kërkesëpadinë e paditëses F..... Z..... nga Prishtina, dhe e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit në aksidentin e shkaktuar me datë 01.05.2015, t’ia paguajë në mënyrë shumat si vijon: Në emër të dëmit jo material, për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....1.200 euro, për friken e pësuar, shumën prej.....1.000 euro. Në emër të dëmit material: për ushqim të përforcuar, shumën prej.....150 euro, për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 100 euro. Në pikën e II-të të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, që paditëses t’ia paguaj kamatën në lartësi prej 8% për pjesën e aprovuar të padisë, ashtu që për dëmin material kamata do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë datë 08.09.2015, kurse për dëmin jo material nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit 21.09.2022 e deri në

pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 809,00 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit. Në pikën e III-të të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses F..... Z....., mbi shumat e aprovuara dhe atë: për dhembjet e përjetuara fizike shumë prej 3,340 euro; për frikën e pësuar shumë prej 1,485 euro; për ushqim të përforcuar shumë prej 312,00 euro; për përkujdesje të personit të tretë shumë prej 208,00 euro, kurse në tërësi refuzohet kërkesa për kompensim në emër të rehabilitimit klimaterik në shumë prej 220,00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, kontatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes fakike dhe zbatimit të gabaur të të drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta prish aktgjykimin e atakuar dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195, paragrafi, 1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja F..... Z....., përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar B..... A....., avokat nga Prishtina, me datë 08.09.2015, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt të padisë kompensim i dëmit. Në padi ka theksuar se me datë 01.05.2015, në magjistralen Prishtinë - Gjilan ishte shkaktuar aksident komunikacioni, ku deri tek aksidenti ka ardhur derisa paditësja F..... Z..... ishte duke udhëtuar me automjetin e tipit VW Golf me targa 01-273-HF në cilësinë e pasagjerit, kur papritmas automjeti i tipit VW Passat me targa 01-627-AP të cilin po e drejtonte E..... K..... ka marrë veprim kthimi në të majtë në mënyrë të pasigurt me që rast ka goditur automjetin në të cilin ka qenë paditësja duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore. Ka shtuar se si pasojë e këtij aksidenti, paditësja ka pësuar dëm material dhe jo material të llojeve dhe intensiteteve të ndryshme. Përfaqësuesi i paditësit ka bërë ndryshimin e padisë në drejtim të rritjes së sajë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Në përgjigjen në padi, si dhe në seancat gjyqësore, përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës e ka kontestuar kërkesëpadinë vetëm për nga lartësia, për dëmin material dhe jo material, për shkak se shumat e kërkuara janë të pabazuara dhe të pa justifikuara, dhe po ashtu në kundërshtim me praktikën gjyqësore. E paditura pas trajtimit të kërkesës për kompensim të dëmit material dhe jo material ka dal me ofertë prej 900.00 euro, e cila shumë sipas saj është reale dhe të njëjtën e paditura e ofron edhe në gjykatë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2092/15 të

datës 21.09.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se përgjatë procedurës gjyqësore rezultoi të mos jetë kontestues fakti se shkaktari i aksidentit të komunikacionit, nga ka rrjedhur edhe dëmi, të ketë qenë i siguruan tek e paditura. Po ashtu nuk ka qenë kontestuese as baza juridike e kërkesëpadisë. Në këtë drejtim, gjykata nuk u lëshua në vlerësim e këtyre fakteve. Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet lartësia e kompensimit, për të cilën përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse kanë paraqitur argumente të ndryshme mes tyre. Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku, gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertizës, me ekspertë nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë. Eksperti ortoped Xh..... S..... në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, ka konstatuar se paditësja si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka pësuar lëndime trupore që cilësohen si dëmtime të lehta trupore. Sipas mendimit të ekspertes së psikiatrisë S.....B....., paditësi si pasojë e aksidentit të shkaktuar, ka përjetuar intensitete frike të llojeve të ndryshme. Andaj, gjykata e aprovoj pjesërisht të kërkesëpadinë e paditës duke i gjykuar shumat si në dispozitivin e aktgjykimit. Vendimin e saj, gjykata e bazoi në nenin 159 paragrafi 1, nenin 137, nenin 183 paragrafin 1 të LMD-së dhe nenin 323 të LPK-së. Për sa i përket kamatës ligjore, gjykata vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e mori konform nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së. Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet më dëmin material dhe jo material, gjykata vlerësoi se kompensim përtej shumave të gjykuara, nuk do të ishin në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave nga e drejta materiale, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nuk gjeti as shkelje që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, e as shkeljeve të tjera nga neni 181 paragrafi 1 dhe 182 paragrafi 2, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për aprovimin e pjesërishtë të kërkesëpadisë së paditëses, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe

mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses.

Një ashtu, edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë, kur me rastin e vendosjes, është zbatuar neni 159, paragrafi 1 i LMD-së, që përcakton se *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”*, dhe gjithashtu edhe neni 137 i LMD-së që përcakton se *“: Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material), ndërsa dispozita e nenit 183 paragrafi 1 e LMD-së përcakton se “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*, prandaj, mbi bazën e të gjitha këtyre arsyeve, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se pretendimet ankimore të palës së paditur në raport me mënyrën e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë rezultojnë të pa bazuara dhe pa argumentuara dhe si të tilla refuzohen.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet ankimore të të paditurit, duke vlerësuar të njëjtat se janë përsëritje e kundërshtimeve që janë bërë përmes përgjegjës në padi e të cilat pretendime u vlerësuan nga gjykata e shkallës së parë dhe njëkohësisht nga Gjykata e Apelit e cila i vlerëson se nuk janë me ndikim për një vendim ndryshe. Kjo për faktin se baza ligjore e kërkesëpadisë së paditëses nuk ishte kontestuar, ndërsa për vërtetimin e lartësisë së dëmit material dhe jo material i cili iu ishte shkaktuar paditëses si pasojë e aksidentit gjykata vendimin e ka bazuar në ekspertizë, me ekspertë nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë. Eksperti ortoped Xh..... S.....në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, ka konstatuar se paditësja si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka pësuar lëndime trupore që cilësohen si dëmtime të lehta trupore. Gjykata në emër të dhimbjeve fizike kishte aprovuar kërkesën në shumën prej 1,200 euro, të cilën shumë Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e vlerëson si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse sipas të njetëe ekspertizë, paditësja, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të rëndë ka pasur për 15 minuta, me intensitet të rëndë 24 orë, me intensitet të mesëm 14 ditë, si dhe me intensitet të ulët janë ende prezente. Ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 2 javëve, duke përfshirë ndihmën në mbajtjen e higjienës, veshmbathjeve, ushqimit, me crast iu njoh shuma prej 100 euro si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 21 ditë, i pajisur me proteina, minerale, vitamina etj, andaj, iu njoh shuma prej 150 euro. Në emër të frikës gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vlerësuar shumën prej 1.000 euro, ngase sipas mendimit të ekspertes së psikiatrisë Samire Braina, paditësja si pasojë e aksidentit të shkaktuar, ka përjetuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekondash, si reagim i fuqishëm afektiv, ndaj rrezikut të

paraqitur, pra frikë nga vdekja, frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar për rreth 48 orë, kohë e nevojshme për marrjen e ndihmës së parë dhe vazhdimin e konsultave të sajë në Qendrën Emergjente në Prishtinë. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar rreth 3 deri në 4 muaj kurse frika e intensitetit të ulët ende zgja, andaj ekspertizat mjekësore të ortopedisë dhe psikiatrisë, drejtë janë pranuar në tërësi si të besueshme, ngase të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, po ashtu të punuara sipas vëllimit të përcaktuar, po ashtu duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore. Në fund, Gjykata e Apelit thekson se shumata e aprovuara janë në përputhje dhe në harmoni edhe me Udhëzuesin e për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësinë e shpërblimit të drejtë të dëmit jo material të Gjykatës Supreme të Kosovës i protokollur me numër 41/2023 me datë 27.02.2023.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të të paditurës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7334/2022 me datë 17.04.2024

**Kryetari i Kolegjit,
Ardian Ajvazi**